

PROGRAMI I PUNËS DHE KALENDARI I AKTIVITETEVE (2025-2027)

PLANET E MENAXHIMIT TË PELGJEVE LUMORE DRINI I BARDHË, IBËR, MORAVË E BINÇËS DHE LEPENC PËR PERIUDHËN E PLANIFIKIMIT 2028–2033

Dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

1. HYRJA.....	4
SFONDI	6
1.1 Menaxhimi dhe planifikimi i burimeve ujore në Kosovë.....	6
1.2 Pellgjet lumore në Kosovë – Të dhënat kryesore.....	7
2. PËRMBAJTJA E PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PELGJEVE LUMORE	9
2.1 Kushtet sipas Ligjit të Ujërave të Kosovës	9
2.2 Përditësimet nga periudha e kaluar e planifikimit	11
3. AKTET RELEVANTE TË BE-SË DHE KALENDARI I AKTIVITETEVE PËR HARTIMIN E PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PELGJEVE LUMORE.....	15
NEVOJA PËR PËRFSHIRJE TË PALËVE TË INTERESIT	15
3.1 Kërkesat për përfshirjen e palëve të interesit sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës	16
3.2 Kalendar i aktiviteteve për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore sipas aktit relevant të BE-së	17
4. KORNIZA KOHORE DHE PROGRAMI I PUNËS (2025-2027) PËR PËRGATITJEN E PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PELGJEVE LUMORE PËR PERIUdhËN E PLANIFIKIMIT 2028–2033	18
PLANI I PUNËS ME AFATIN KOHOR INDIKATIV	18
5. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË PROCESIN E ZHVILLIMIT TË PMPL-SË.....	22
6. KONTAKTI DHE PROCEDURA PËR MARRJEN E DOKUMENTACIONIT DHE INFORMACIONIT TË NEVOJSHËM.....	23

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Korniza kohore e PMPL të BE-së dhe afatet e publikimit.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 2: Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e PMPL-së	22
Tabela 3: Kontakti për marrjen e të dhënave, dokumentacionit dhe informacionit.....	23

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Pellgjet lumore në Kosovë.....	7
Figura 2. Korniza kohore e PMPL dhe PMRP e BE-së në të gjitha shtetet anëtare të saj	17

LISTA E SHKURTESAVE

Mbulesa e tokës CORINE	Produkti CORINE Land Cover (CLC) ofron një inventar pan-evropian të mbulimit të tokës dhe përdorimit të tokës me 44 klasa tematike, duke filluar nga zonat e gjera të pyllëzuara deri te vreshtat individuale. Produkti përditësohet me status të ri dhe ndryshon shtresa çdo gjashtë vjet - me përditësimin më të fundit të bërë në vitin 2018.
DRASTIC	Metoda e trupave ujqorë nëntokësorë për të vlerësuar cënueshmërinë ndaj ndotjes bazuar në parametrat gjeologjik
AEM	Agjencia Evropiane e Mjedisit
BE	Bashkimi Evropian
PMRP	Plani i Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet
MIBU	Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujqore
AKMM	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
MMPHI	Ministrisa e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
PM	Programi i Masave
ARPL	Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore
PMPL	Plani i Menaxhimit të Pellgut Lumor
SINTACS	Metoda e trupave ujqorë nëntokësorë për të vlerësuar cënueshmërinë e akuiferit, duke përdorur shtatë parametra mjedisorë (thellësia e ujit, infiltrimi efektiv, kushtet e pangopura, mjedisi i tokës, karakteristikat hidrogjeologjike të akuiferit, përçueshmëria hidraulike dhe pjerrësia topografike)
IVTU	Instrumenti i Vlerësimit të Tokës dhe Ujit (SWAT)
ÇRMU	Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit (SWMI)
SIU	Sistemi Informativ Ujqor
DKU	Direktiva Kornizë për Ujqëra
MGPI	Mekanizmi Gjithëpërfshirës i Palëve të Interesit (MSPM)

1. HYRJA

Menaxhimi efektiv i pellgjeve lumore është thelbësor për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, shëndetin e ekosistemit dhe zhvillimin socio-ekonomik të çdo rajoni.

Në Kosovë, një vend i karakterizuar me veçoritë e tij të ndryshme hidrologjike dhe kërkesa në rritje për ujë, menaxhimi holistik i pellgjeve lumore është bërë një prioritet kritik, si një nevojë urgjente për strategji të koordinuara të menaxhimit që përputhen me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat (EU WFD) dhe mbështesin aspiratat e vendit për integrim në BE. Potenciali vjetor i ujit sipërfaqësor i vendit është 2,81 miliardë m³, ndërsa konsumi i ujërave të ëmbla në vitin 2019 ishte 451,5 milion m³ (16% e totalit të ujit në dispozicion). Megjithatë, për shkak të investimeve të pamjaftueshme në infrastrukturën ujore gjatë një periudhe të gjatë, niveleve të larta të shpërndarjes së ndotjes dhe praktikave të pasiguruara të menaxhimit të ujit, Kosova është një vend me stres ujor. Për më tepër, për shkak të efekteve negative të ndryshimeve klimatike dhe rritjes së pritshme të kërkesës për ujë për bujqësinë, industrinë dhe nevojat urbane, niveli i stresit pritet të rritet edhe më tej në të ardhmen.

Pellgjet lumore të Kosovës, duke përfshirë lumenjtë Drini i Bardhë, Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenc, formojnë një rrjet të ndërlikuar që shërben për funksione jetike për bujqësinë (58% konsumi i ujit), industrinë (19%), furnizimin me ujë për amvisëri (23%) dhe biodiversitetit. Menaxhimi i integruar i ujit në këto pellgje siguron balancimin e përdorimeve të ndryshme të ujit, duke mbështetur si nevojat njerëzore, ashtu edhe shëndetin ekologjik. Megjithatë, këto burime përballen me presione në rritje nga urbanizimi, ndryshimet klimatike dhe aktivitetet ekonomike, duke çuar në degradimin e cilësisë së ujit, reduktimin e regjimeve të rrjedhës dhe humbjen e habitatit. Kjo krijon një nevojë urgjente për strategji të koordinuara menaxhimi, që përputhen me Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat (EU WFD) dhe mbështesin aspiratat e Kosovës për integrim në BE.

Mbrojtja e cilësisë së ujit është thelbësore për të siguruar ruajtjen e sasisë së mjaftueshme dhe standardeve të pranueshme të cilësisë. Ligji për menaxhimin e burimeve ujore, i bazuar në parimet e Direktivës Kornizë për Ujërat (WFD), ofron një qasje sistematike për arritjen e këtyre objektivave – e cila realizohet përmes procesit të planifikimit të menaxhimit të pellgjeve lumore, ku **planet e menaxhimit të pellgjeve lumore (PMPL) zhvillohen, rishikohen dhe përditësohen çdo gjashtë vjet**. Për më tepër, ciklet e planifikimit kombëtar duhet të sinkronizohen për të filluar në të njëjtin vit në të gjitha vendet e BE-së, duke siguruar një qasje të koordinuar për menaxhimin e ujit në të gjithë Evropën.

Ky dokument ka për qëllim të përcaktojë hapat kryesor (udhërrëfyesin) dhe pikënisjet për përgatitjen e Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore (PMPL) për periudhën e planifikimit 2028-2033 për rajonet e pellgjeve lumore:

- Drini i Bardhë;
- Ibër;
- Moravë e Binçës;
- Lepenc.

Sqarim: Ky dokument (*program i punës – roadmap*) nuk ka të bëjë me Planin e Menaxhimit të Pellgut Lumor (RBMP) për Drinin e Bardhë, i cili tashmë është miratuar nga Qeveria. Po ashtu, ky dokument nuk ka të bëjë me PMPL-të për Ibër, Moravë e Binçës dhe Lepenc, të cilat aktualisht janë në formë drafti të publikuar në uebfaqen e Qeverisë për konsultime publike. Ato do të vazhdojnë proceset e tyre përkatëse të miratimit dhe të zbatimit deri në vitin 2028.

Me këtë programin e tanishëm të punës (roadmap) cikli i PMPL-ve po harmonizohet me afatet kohore të Bashkimit Evropian. Ky harmonizim siguron që RBMP-të e përditësuara të jenë në përputhje me ciklin e katërt të BE-së.

Kështu, me këtë plan aktual, po prezantojmë një proces të përditësimit, zhvillimit dhe harmonizimit të të gjitha katër PMPL-ve, që mbulon periudhën nga viti 2028 deri në vitin 2033.

PMPL-të janë planifikuar të miratohen deri në dhjetor 2027, përmes një procedure që do t'u sigurojë të gjitha palëve të interesit qasje në informacion, konsultim dhe pjesëmarrje aktive në procesin e përgatitjes së

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe institucionet e saj vartëse, si Autoriteti i Rajonit të Pellsjeve Lumore (ARPL), së bashku me Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AMMK), Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK) dhe Departamentin e Inspektoratit, janë institucionet kryesore përgjegjëse për menaxhimin e mjedisit dhe burimeve ujore, duke garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë të mjedisit në pellsjet e lumenjve të Kosovës. Në mënyrë specifike, ARPL është institucioni kryesor përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e Planeve të Menaxhimit të Pellsjeve Lumore (PMPL) në Kosovë.

MMPHI mbështet përfshirjen aktive të palëve të interesit dhe shoqërisë civile në zhvillimin PMPL, të cilat formulohen me pjesëmarrjen e palëve të interesit përmes një sërë fushatash konsultimesh publike. Sipas dispozitave të Nenit 33, paragrafi 1, pika 1 dhe 2, dhe Nenit 84 të Ligjit për Ujërat të Kosovës Nr. 04/L-147, të paktën tre vjet para fillimit të një periudhe planifikimi gjashtëvjeçare, përgatitet dhe publikohet një orar dhe program pune për përgatitjen e Planit, së bashku me një kornizë kohore për zbatimin e tij.

Neni 33 thekson transparencën, afatet e strukturuar kohore dhe pjesëmarrjen aktive të publikut si elemente thelbësore për zhvillimin e një plani të fuqishëm dhe të pranuar gjerësisht të Menaxhimit të Pellsjeve Lumore. Ai përcakton një proces të strukturuar dhe transparent për hartimin, rishikimin dhe konsultimin me publikun mbi PMPL në Kosovë. Procesi fillon me sigurimin e pjesëmarrjes publike, duke vënë në dispozicion dokumentet dhe informacionin kyç për palët e interesit dhe publikun në intervale të caktuara. Kjo përfshin publikimin e një kornize kohore dhe programin e punës për hartimin e planit, duke ofruar një pasqyrë të çështjeve të rëndësishme të menaxhimit të ujit të paktën tre vjet përpara periudhës së synuar të planit, si dhe ndarjen e një versioni të draftuar të planit të paktën një vit përpara zbatimit të tij. Qeveria e Kosovës luan një rol qendror në zyrtarizimin e pjesëmarrjes publike, duke nxjerrë një vendim zyrtar për paraqitjen e planit për shqyrtim publik. Ky vendim duhet të jetë i qasshëm publikisht përmes publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie. **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)** është përgjegjëse për organizimin e shqyrtimeve publike dhe debateve profesionale, duke krijuar mundësi për palët e interesit, ekspertët dhe qytetarët për të dhënë komente. Kjo qasje pjesëmarrëse siguron që të merren parasysh perspektiva të ndryshme në zhvillimin e planit. Krejt në fund, Ministria është e detyruar të dokumentojë në mënyrë të detajuar rezultatet e këtyre konsultimeve. Kjo përfshin mbledhjen e shënimeve të shqyrtimeve profesionale dhe ato publike, si dhe bashkëngjitjen e shënimeve stenografike nga diskutimet. Këto të dhëna shërbejnë si dëshmi e përfshirjes dhe gjithëpërfshirjes së procesit të konsultimeve dhe ndihmojnë në përpunimin e versionit përfundimtar të Planit të Menaxhimit të Pellsjeve Lumore.

Gjithashtu, Neni 84 përshkruan një proces të strukturuar, transparent dhe pjesëmarrës për planifikimin e menaxhimit të burimeve ujore, duke siguruar mundësinë për të gjitha palët e interesuara të kontribuojnë në qeverisjen e qëndrueshme dhe efektive të ujit në Kosovë. Neni 84 thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut gjatë proceseve të hartimit, miratimit dhe rishikimit të Strategjisë Shtetërore për Ujëra dhe PMPLL në Kosovë. Ai përcakton përgjegjësi të qarta për sigurimin e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe angazhimit në kohë me palët e interesuara. Procesi fillon me hartuesin që përcakton një plan projekti për debat publik para se të finalizohen dokumentet. Për të siguruar një pjesëmarrje domethënëse, publiku duhet të informohet një vit përpara periudhës së hartimit. Ky njoftim ka për qëllim të përgatisë palët e interesuara, përfshirë autoritetet qendrore dhe lokale të qeverisjes, organizatat joqeveritare, mbajtësit e të drejtave të ujit dhe palë të tjera të interesuara, duke u mundësuar atyre të kontribuojnë në mënyrë efektive. Propozuesi i Strategjisë dhe i PMPL-së është përgjegjës për angazhimin aktiv me publikun, duke siguruar komunikim të hapur dhe përditësime për progresin e hartimit të paktën një vit para zbatimit të planit. Për më tepër, një version i draftit duhet të publikohet për shqyrtim dhe konsultim publik jo më pak se një vit përpara periudhës që mbulon plani. Palët e interesit, duke përfshirë persona juridik dhe fizik, lejohen të paraqesin vërejtje për planin e projektit brenda dy muajve pas botimit të tij. Kjo siguron që të merren parasysh të gjitha shqetësimet dhe sugjerimet e rëndësishme gjatë procesit të hartimit. Për të ruajtur fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë, PMPL duhet të rishikohet çdo gjashtë vjet. Çdo ndryshim apo përditësim duhet të ndjekë të njëjtat procedura transparente si procesi i miratimit origjinal.

Për më tepër, pjesëmarrja publike garantohet në procedurat për dhënien e koncesioneve dhe lejeve të ujit, të cilat do të rregullohen në mënyrë të veçantë nga një akt nënligjor për lejet e ujit.

Sipas legjislationit shtetëror, PMPL-të do të zhvillohen për një periudhë planifikimi gjashtëvjeçare, duke siguruar përfshirjen e fortë të shoqërisë civile dhe palëve të interesit që në fazën e hershme. Aktivitetet për ciklin aktual të planifikimit janë planifikuar për të siguruar një nivel të lartë të konsultimit publik gjatë zhvillimit të planit, siç përshkruhet në këtë dokument. Angazhimi i hershëm i palëve të interesit na mundëson të kryejmë një shqyrtim më të informuar, bashkëpunues dhe përfundimisht më të fortë të strukturave dhe masave aktuale të PMPL-ve, duke aplikuar këto mësimë në zhvillimin e planit për ciklin e ardhshëm.

SFONDI

1.1 Menaxhimi dhe planifikimi i burimeve ujore në Kosovë

Duke qenë një kandidate potenciale për anëtarësim në BE, Kosova aktualisht është në një proces të vazhdueshëm të harmonizimit të legjislationit të saj me atë BE-së. Në përputhje me dispozitat e Ligjit të Ujërave (Ligji Nr. 04/L-147), Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë Shtetërore të Ujërave për periudhën 2017 – 2036. Kjo strategji është e bazuar në një qasje shumë-sektoriale dhe trajton çështjet më të rëndësishme të lidhura me ujin. Ajo gjithashtu përcakton katër objektiva kryesore: Mbrojtja dhe Zhvillimi i Burimeve të Ujit, Menaxhimi i Integruar i Burimeve të Ujit, Vlerësimi Ekonomik i Përdorimit të Ujit dhe Përshtatja me Direktivat dhe Standardet e BE-së për Ujin, që do të realizohen gjatë periudhës së planifikuar 20-vjeçare.

Për më tepër, në vitin 2022, Qeveria e Kosovës përgatiti një Rishikim të Strategjisë Shtetërore për Ujëra për periudhën 2023-2027 dhe Planin e Veprimit 2023-2025. Ky dokument planifikimi ka si qëllim menaxhimin më efektiv të burimeve të ujit, për të siguruar sasinë dhe cilësinë e duhur të ujit, në përputhje me nevojat e popullsisë dhe zhvillimin ekonomik.

Territori i Kosovës është i ndarë në katër pellgje lumenjsh:

- Drini i Bardhë, që rrjedh në jug-perëndim dhe derdhet në detin Adriatik;
- Ibër, që rrjedh drejt veriut dhe derdhet në Detin e Zi;
- Morava e Binçës, që rrjedh në jug-lindje dhe derdhet në Detin e Zi dhe
- Lepenc, që rrjedh drejt jugut dhe derdhet në detin Egje.

1.2 Pellgjet lumore në Kosovë – Të dhënat kryesore

Kosova, me peizazhin e saj malor dhe fushor dhe klimën e saj kryesisht kontinentale (reshjet mesatare vjetore 600-700 mm), është një vend pa dalje në det që ka katër pellgje kryesore lumenjsh: Drini i Bardhë, Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenci.

Ujërat e vendit janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në hapësirë dhe kohë, gjë që pritët të përkeqësohet gjatë dekadave të ardhshme, duke i bërë të gjitha pellgjet e Kosovës të stresuara. Për shkak të karakteristikave të saj unike natyrore, historisë së investimeve të pakta në infrastrukturën ujore, përdorimit të dobët të ujit në bujqësi dhe sektorë të tjerë ekonomik, si dhe niveleve të larta të ndotjes, Kosova tashmë është një nga vendet më të stresuara të ujit në Evropën Juglindore. Duke pasur parasysh krizën klimatike dhe nevojën në rritje për ujë për minierat, industrinë, zonat urbane dhe bujqësinë, nivelet e stresit parashikohen të rriten në të ardhmen. Menaxhimi i burimeve ujore në Kosovë bëhet edhe më sfidues duke marrë parasysh karakterin ndërkufitar të katër pellgjeve të saj lumore.




Figura 1. Pellgjet lumore në Kosovë

Drini i Bardhë është lumi kryesor në rajonin e Dukagjinit dhe në këtë lumë derdhen të gjitha rrjedhat dhe lumenjtë e tjerë të rajonit. Pellgu mbulon një sipërfaqe prej 4,829 km². Drini i Bardhë përdoret jo vetëm për peshkim dhe nevoja të amvisërisë, por është edhe një burim i rëndësishëm ujitjeje gjatë

periudhës së verës. Drini i Bardhë kalon në Shqipëri, ku bashkohet me Drinin e Zi dhe më pas derdhet në detin Adriatik. Prurja vjetore e ujit është 2,200 milion m³.

Pellgu i lumit *Ibër*. Rajoni i Drenicës dhe Lugina e Kosovës kryesisht kanë disa lumenj dhe përrenj më të vegjël, shumica e të cilëve janë të ndotur dhe mbajnë shumë më pak ujë se sa pellgu i *Drinit*. Një pjesë e madhe e luginës së Kosovës përmes lumit *Sitnica* derdhet në lumin Ibër i cili rrjedh në pjesën veriore dhe verilindore të Kosovës, duke mbuluar një sipërfaqe prej 4,369 km². Lumenjtë më të gjatë dhe më të rëndësishëm janë Ibër (172 km) dhe Sitnica (94 km). Ky pellg ka një popullsi prej rreth 725,000 banorë. Rrjedha vjetore është 771 milion m³.

Pellgu i lumit *Morava e Binçës* mbulon pjesën lindore të Kosovës (1,564 km²) që së bashku me pellgun e Ibër janë degë të Danubit, i cili derdhet në Detin e Zi. Ajo ka një popullsi prej 190,000 banorë. Rrjedha vjetore është 330 milion m³.

Pellgu i *Lepencit* rrjedh në pjesën jugore të territorit, i cili mbulon një sipërfaqe prej 685 km² dhe derdhet në lumin Vardar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe më pas në detin Egje. Në këtë zonë të pellgut lumor jetojnë rreth 160,000 banorë. Rrjedhja vjetore e ujit është 307 milion m³.

2. PËRMBAJTJA E PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PELGJEVE LUMORE

2.1 Kushtet sipas Ligjit të Ujërave të Kosovës

Sipas Aneksit 1 të LIGJIT Nr. 04/L-147

A. Planet e menaxhimit të pellgut lumor duhet të mbulojnë këto elemente:

Përkrahimi i përgjithshëm i pellgut të lumit, duke përfshirë hartimin e vendndodhjes dhe kufijve të trupave të ujërave sipërfaqësore, si dhe ofrimin e informacionit të detajuar për llojet e këtyre trupave dhe eko-regjionet në këtë pellg. Për ujërat nëntokësore, gjithashtu duhet të përfshihen hartat që tregojnë vendndodhjen dhe kufijtë e trupave të ujërave nëntokësore.

Përsa i përket presioneve dhe ndikimeve, **plani ofron një vlerësim të presioneve mbi trupat ujorë**, të cilat përfshijnë ndotjen nga burimet e caktuara (point-source pollution) dhe të shpërndara (diffuse pollution), si dhe efektet e përdorimit të tokës. Ai gjithashtu duhet të mbulojë ndikimet e këtyre presioneve në cilësinë dhe sasinë e ujit, duke u fokusuar veçanërisht në abstraksionet e ujit. Gjithashtu, duhet të përmbledhen ndikimet e aktiviteteve njerëzore në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Parashikohet një **identifikim gjithëpërfshirës i zonave të mbrojtura**, i cili përfshin zonat e caktuara për mbrojtjen e ujit të pijshëm, zonat e ndjeshme ndaj lëndëve ushqyese dhe ato që i nënshtrohen ligjeve për ruajtjen e natyrës, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me standardet mjedisore.

Planet gjithashtu përfshijnë një **rrjet monitorimi** për vlerësimin ekologjik, kimik dhe sasior të ujërave sipërfaqësore dhe trupave ujorë nëntokësorë. Rezultatet e këtyre programeve monitoruese duhet të paraqiten qartë, duke treguar statusin ekologjik dhe kimik të trupave ujorë sipërfaqësorë, gjendjen kimike dhe sasimore të trupave ujorë nëntokësorë dhe statusin e zonave të mbrojtura.

Një aspekt i rëndësishëm i planeve është përcaktimi i **objektivave mjedisore** për çdo trup ujor, duke siguruar që të arrihet dhe ruhet një status i mirë. Duhet të bëhet një identifikim i qartë i rasteve specifike kur trupat ujorë ose zonat e mbrojtura mund të mos përmbushin objektivat mjedisore për shkak të kushteve të veçanta.

Analiza ekonomike e përdorimit të ujit mbulon rikuperimin e kostos së shërbimeve të ujit, duke përfshirë aspektet ekonomike të lidhura me to.

Planet përfshijnë gjithashtu një **rishikim të programeve të masave** që do të plotësojnë kërkesat, të tilla si sigurimi i zbatimit të parimit për rikuperimin e kostos për përdorimin e ujit, adresimi i abstraksioneve të ujit, administrimi i shkarkimeve nga burimet e caktuara dhe parandalimi i incidenteve aksidentale të ndotjes. Masat specifike në lidhje me trupat ujorë nëntokësorë gjithashtu do të përshkruhen.

Pjesëmarrja e publikut është një element kyç, prandaj planet ofrojnë një **përmbledhje të informacionit publik dhe masave të konsultimit**, duke përfshirë autoritetet përgjegjëse për zbatimin e direktivës, së bashku me procedurat për marrjen e dokumenteve dhe informacionit përkatës.

Së fundmi, si pjesë e përditësimit, Planet e Menaxhimit të Pellgjeve përfshijnë një **përmbledhje të çdo ndryshimi ose përditësimi**, një **vlerësim të progresit** në arritjen e objektivave mjedisore dhe një shpjegim për çdo masë nga versionet e mëparshme që nuk është realizuar. Masat shtesë të miratuara që nga përditësimi i fundit i planit do të rishikohen për të siguruar përputhshmërinë e vazhdueshme.

PËRMBAJTJA E PLANIT PËR MPL	
1. përshkrim i përgjithshëm i karakteristikave të distriktit të pellgut të lumit, siç kërkohet në nenin 5 dhe Aneksin II.	hartimi i vendndodhjes dhe kufijve të trupave të ujërave sipërfaqësore.
	hartimi i eko-regjioneve dhe llojeve të trupave të ujërave sipërfaqësore brenda pellgut të lumit
	identifikimi i kushteve referuese për llojet e trupave të ujërave sipërfaqësore
	hartimi i vendndodhjes dhe kufijve të trupave të ujërave nëntokësorë

2. përmbledhje e presioneve të rëndësishme dhe ndikimeve të aktivitetit njerëzor në gjendjen e ujërave sipërfaqësorë dhe ujërave nëntokësorë	vlërësimi i ndotjes nga burimet e caktuara (point source) të ujërave sipërfaqësorë dhe ujërave nëntokësorë
	vlërësimi i ndotjes nga burimet e shpërndara të ujërave sipërfaqësorë dhe ujërave nëntokësorë, duke përfshirë një përmbledhje të përdorimit të tokës
	vlërësimi i presioneve mbi statusin sasior të ujit, duke përfshirë abstraksionet
	analiza e ndikimeve të tjera të aktivitetit njerëzor në gjendjen e ujit
3. identifikimi dhe hartimi i zonave të mbrojtura siç kërkohet nga Neni 6 dhe Aneksi IV	zona të caktuara për abstraksionet e ujit të destinuar për konsum njerëzor
	zona të mbrojtura për gjallesa ujore me rëndësi ekonomike
	trupa uji të përcaktuara si ujëra rekreative, duke përfshirë zonat e përcaktuara si ujëra për larje.
	zona të ndjeshme ndaj lëndëve ushqyese, duke përfshirë zonat e përcaktuara si zona të cënueshme
4. hartë e rrjeteve të monitorimit të krijuara për qëllimet e Nenit 8 dhe Aneksit V, si dhe një paraqitje në formë harte e rezultateve të programeve të monitorimit të kryera sipas këtyre dispozitave për statusin e:	ujërave sipërfaqësore (ekologjike dhe kimike)
	ujërave nëntokësore (kimike dhe sasiorë)
	zonave të mbrojtura
5. listë e objektivave mjedisore të përcaktuara sipas Nenit 4.	ujërat sipërfaqësore
	ujërat nëntokësore
	zonat e mbrojtura
6. përmbledhje e analizës ekonomike të përdorimit të ujit, siç kërkohet në Nenin 5 dhe Aneksin III.	
	Identifikimi i rasteve kur është përdorur Neni 4(4), (5), (6) dhe (7), së bashku me informacionin përkatës.
7. përmbledhje e programit ose programeve të masave të miratuara sipas Nenit 11, duke përfshirë metodat që do të përdoren për arritjen e objektivave të përcaktuara sipas Nenit 4 përmes këtyre masave.	7.1. përmbledhje e masave të nevojshme për të zbatuar legjislacionin për mbrojtjen e ujit
	7.2. raport mbi hapat dhe masat praktike të marra për zbatimin e parimit të rikuperimit të kostove të përdorimit të ujit
	7.3. përmbledhje e masave të marra për të plotësuar kërkesat për ujin që përdoret për abstraksionin e ujit të pijshëm
	7.4. përmbledhje e kontrolleve për nxjerrjen dhe bllokimin e ujit, duke përfshirë referencën në regjistrat dhe identifikimin e rasteve ku janë bërë përjashtime
	7.5. përmbledhje e kontrolleve të miratuara për shkarkimet e burimeve të caktuara (point sources) dhe aktivitete të tjera me ndikim në gjendjen e ujit
	7.6. identifikim i rasteve kur janë autorizuar shkarkimet e drejtpërdrejta në ujërat nëntokësore
	7.7. përmbledhje e masave të marra për substancat me prioritet

	7.8. përmbledhje e masave të marra për të parandaluar ose zvogëluar ndikimin e incidenteve të ndotjes aksidentale
	7.9. përmbledhje e masave të marra për trupat e ujit që nuk pritët të arrijnë objektivat
	7.10. detajet e masave plotësuese të identifikuar si të nevojshme për të përmbushur objektivat mjedisore të vendosura
8.	regjistër i çdo programi dhe plani menaxhimi më të detajuar për rajonin e pellgut të lumenjve që trajton nën-pellgje të caktuara, sektorë, çështje ose tipe uji, së bashku me një përmbledhje të përmbajtjes së tyre
9.	përmbledhje e masave të marra për informimin dhe konsultimin publik, rezultatet e tyre dhe ndryshimet në planin e bërë
10.	listë të autoriteteve kompetente

2.2 Përditësimet nga periudha e kaluar e planifikimit

PMPL për Pellgun e Lumit Drini i Bardhë, i cili mbulon ciklin e parë të menaxhimit nga 2021 deri në 2027, është zhvilluar dhe miratuar si pjesë e përpjekjeve të Kosovës për menaxhimin efikas të pellgut më të madh të lumenjve të saj.

PMPL është një dokument strategjik që përcakton objektivat, masat dhe veprimet e nevojshme për të arritur një menaxhim të qëndrueshëm të ujërave brenda Pellgut të Lumit Drini i Bardhë. Ai është në përputhje me parimet e Direktivës Kornizë të BE-së për Ujërat, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, përmirësimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve ujore. Plani u zhvillua përmes një procesi gjithëpërfshirës që përfshin mbledhjen e të dhënave, angazhimin e palëve të interesit dhe përputhjen me politikat shtetërore dhe ato të BE-së për menaxhimin e ujërave. Zbatimi i tij është thelbësor për adresimin e sfidave të lidhura me ujin, duke përfshirë kontrollin e ndotjes, menaxhimin e rrezikut nga përmbajtjet dhe ruajtjen e ekosistemeve ujore brenda pellgut. Me përfundimin e ciklit të tanishëm të menaxhimit në vitin 2027, janë duke u zhvilluar përgatitjet për ciklin e ardhshëm (2028-2033), me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit të burimeve ujore në pellgun e lumenjve.

Gjatë periudhës 2020-2024, Kosova implementoi një qasje gjithëpërfshirëse dhe jashtëzakonisht të angazhuar për menaxhimin e burimeve ujore në pellgjet e lumenjve, në përputhje me parimet e MIBU dhe Direktivës Kornizë të BE-së për Ujërat (EU WFD). Draft Planet e Menaxhimit të Pellgjeve Lumore për Ibër, Moravën e Binçës dhe Lepenc u përgatitën në bazë të një mbledhjeje intensive të të dhënave, punës analitike dhe procesit të përfshirjes së palëve të interesit. Projektplanët, të cilët mbulojnë periudhën e planifikimit 2025-2027, janë aktualisht nën konsultime publike dhe po presin miratimin përfundimtar nga Qeveria e Kosovës.

Megjithatë, edhe pse gjatë viteve të fundit Kosova ka bërë përparim të rëndësishëm në formulimin e strategjive dhe planeve zhvillimore të sektorit të ujit, si dhe në hartimin e kornizës ligjore dhe krijimin e institucioneve për operimin e këtij sektori, një veprim më i koordinuar për realizimin e menaxhimit të integruar të burimeve ujore (MIBU) është i nevojshëm. Në këtë aspekt, perspektivat si ulja e presioneve mbi trupat ujorë, optimizimi i potencialit ekonomik të burimeve ujore për zhvillimin e vendit, reduktimi i rreziqeve të lidhura me ujin dhe përmirësimi i kapacitetit absorbues të pellgjeve të lumenjve janë të rëndësishme për të arritur një shpërndarje të drejtë të përfitimeve që lidhen me ujin në shoqëri.

Periudha e planifikimit për PMPL 2028-2033 do të fokusohet në zbatimin e parimeve dhe praktikave të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (MIBU), duke siguruar burime të mjaftueshme uji për njerëzit, ekonominë dhe ekosistemet. Efektivisht, rishikimi i PMPL-ve për periudhën e planifikimit 2028-2033 do të përfshijë:

1. Analiza fillestare e dokumenteve ekzistuese, analiza e boshllëqeve të PMPL ekzistues për Drinin e Bardhë / PMPL-të draft për Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenc, si dhe analiza e të

- dhënave për monitorimin e sasive dhe cilësisë së ujit, ndërkohë që do të përditësohen pjesët narrative ekzistuese të raporteve.
2. Azhurimi dhe përmirësimi i të gjitha studimeve dhe analizave përkatëse ekzistuese (p.sh., vlerësimi i presionit, ndikimit dhe rrezikut, analiza ekonomike, etj.), bazave të të dhënave, hartave dhe produkteve të tjera në një format të përshtatshëm që siguron përputhshmëri me Sistemin Informativ Ujor të Kosovës (SIU).
 3. Analiza e të dhënave ekzistuese të monitorimit dhe hartimi i programeve 3-vjeçare të monitorimit. Analiza do të përfshijë grupe të dhënash historike dhe të dhëna nga pilot programi i monitorimit të zbatuar në kuadër të MIBU-K Faza 1. Qëllimi është të vlerësohet potenciali dhe konsistenca e sistemit të ri të monitorimit meteorologjik dhe hidrologjik në Kosovë, i cili synon planifikimin e përdorimit të sistemit në rishikimin e PMPL-ve, si dhe për hartimin e dy programeve pasuese të monitorimit 3-vjeçar – Programi i Monitorimit të Ujit 1 (2025 - 2027) dhe Programi i Monitorimit të Ujit 2 (2028 - 2031), të cilat janë planifikuar të mbështeten nga IWRM-K në Fazën 2. Ridizajnimi i programeve të monitorimit do të përshtatet për të përmbushur kërkesat e strategjisë dhe standardeve të përbashkëta të zbatimit të BE-së.
 4. **Identifikimi dhe analiza e Çështjeve të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujërave (ÇRMU);** ÇRMU janë presionet kryesore që ndikojnë në statusin ekologjik dhe kimik të burimeve ujore në të gjithë pellgun, duke përfshirë ndotjen nga substancat organike, lëndët ushqyese, substancat e rrezikshme dhe ndryshimet hidromorfologjike. Identifikimi i ÇRMU është një kërkesë e Direktivës Kornizë për Ujërat (DKU), që shërben si bazë për fokusin e PMPL-ve dhe ka një rol të rëndësishëm në informimin e publikut dhe në angazhimin e tij lidhur me çështjet dhe mënyrën se si ato duhet të adresohen. Analiza e ÇRMU do të realizohet në nivel pellgu dhe do të bazohet në studimet dhe analizat e mëparshme, PMPL ekzistuese për Drinin e Bardhë, si dhe draftet e PMPL për Ibër, Moravën e Binçës dhe Lepenc, duke përfshirë të dhënat e ekspertëve dhe burime të tjera. Ky aktivitet do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët shtetërorë, grupet tematike, agjencitë qeveritare dhe AEM. Raportet dhe dokumentet e ÇRMU do të publikohen në faqen e internetit të MMPHI-së për konsultim publik.
 5. Përgatitja e Dokumenteve Konceptuale për **studimet tematike**, duke siguruar rishikimin fillestar të PMPL-së ekzistuese për Drinin e Bardhë dhe draft PMPL-ve për Ibër, Moravën e Binçës dhe Lepencin, duke analizuar të dhënat e monitorimit të cilësisë së ujit (gjendja) dhe analizën e ÇRMU-ve. Ky proces do të rezultojë në identifikimin e boshllëqeve kritike në të dhëna/informacione që pengojnë rishikimin dhe azhurnimin e draft PMPL-ve ekzistuese. Përpjekjet do të përqendrohen në zhvillimin e Dokumenteve Konceptuale për zbatimin e studimeve tematike specifike, të cilat do të adresojnë këto boshllëqe. Këto koncepte do të shërbejnë si bazë për përgatitjen e studimeve tematike, të cilat do të realizohen paralelisht me rishikimin e draft PMPL-ve ekzistuese.
 6. **Përmirësimi (azhurimi) dhe funksionimi i modelit SWAT; Instrumenti për Vlerësimin e Tokës dhe Ujit (IVTU)** i përdorur gjatë hartimit të Studimit të Balancit Ujor në kuadër të Fazës 1 të IWRM-K, rezultatet e të cilit janë përdorur si bazë për përgatitjen e draft PMPL-ve ekzistuese për Kosovën. Modeli analitik SWAT zbatohet në pellgje të vogla ujëmbledhëse deri në nivel të pellgjeve lumore dhe përdoret për të simuluar cilësinë dhe sasinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe për të parashikuar ndikimin mjedisor të përdorimit të tokës, praktikave të menaxhimit të tokës dhe ndryshimeve klimatike. Modeli i aplikuar SWAT do të përmirësohet për të mundësuar modelimin specifik të pellgut të ngarkesave të ndryshme të ndotjes dhe lëndëve ushqyese në nivel shtegu. Ky përmirësim, i kombinuar me të dhëna të reja monitorimi, do të lehtësojë analizën e presioneve dhe ndikimeve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe vlerësimin e rrezikut. Analizat do të ndihmojnë gjithashtu në identifikimin e masave efektive zbutëse me referencë hapësimore duke u fokusuar në nivelin e trupit ujor, duke mbështetur procesin e rishikimit të PMPL-ve dhe përcaktimin e prioritetëve për masat e

bazuara në PM, me qëllim zbatimin e PMPL-së ekzistuese për Drinin e Bardhë / draft PMPL-ve për Ibër, Moravën e Binçës dhe Lepencin. Përveç azhurimit me të dhëna të reja, planifikohen dy ekzekutime të modelit SWAT gjatë periudhës 40-mujore, të cilat do të ofrojnë informacion kyç për zhvillimin e draftit dhe versionit përfundimtar të PMPL-ve.

7. **Përmirësimi i vlerësimit të rrezikut dhe cenueshmërisë së ujërave nëntokësore.** Aktivitetet njerëzore direkte dhe indirekte, si përdorimi i plehrave dhe pesticideve në bujqësi, asgjësimi i patrajtuar i ujërave të zeza nga amvisëritë dhe kullimi i deponive në lumenj, përbëjnë shkaqet kryesore të degradimit të cilësisë së ujërave nëntokësore dhe ndikojnë negativisht në akuiferët. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të mjaftueshme mbi cilësinë e ujërave nëntokësore, është e vështirë të realizohet një vlerësim i plotë i gjendjes. Për këtë arsye, janë zhvilluar shumë qasje për vlerësimin e cenueshmërisë së ujërave nëntokësore, përfshirë metodat e bazuara në procese, metodat statistikore dhe metodat e mbivendosjes/indeksit, secila me avantazhet dhe kufizimet e veta. Si rrjedhojë, informacioni mbi mbulesën tokësore do të përdoret për të vlerësuar rrezikun e shkaktuar nga presionet e aktiviteteve mbi sipërfaqen e tokës. Duke përdorur informacionin CORINE mbi mbulesën tokësore, përfshirë zonat e minierave dhe deponive, zonat urbane, ato bujqësore, pyjet, kullotat dhe mjediset e tjera natyrore, do të vlerësohet rreziku i mundshëm i kontaminimit të trupave ujqorë nëntokësorë. Si alternativë, mund të përdoret metoda e mbivendosjes/indeksit **SINTACS**, e cila është një variant i metodës **DRASTIC** dhe ka qenë e përdorur gjerësisht për vlerësimin e cenueshmërisë së ujërave nëntokësore në nivel global.
8. **Përgatitja e PMPL-ve dhe planeve të veprimit për zbatimin e masave PM.** Analiza e ÇRMU-ve dhe analiza e presioneve dhe ndikimeve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, siç përshkruhet më lart, do të përfshijë:
 - a. Identifikimi i masave bazë dhe plotësuese; fushëveprimi i masave bazë dhe plotësuese, siç specifikohet në DKU
 - b. Analiza ekonomike e kostos dhe përfitimeve të përdorimit të ujit dhe masave të identikuara. Objektivat specifike të analizës përfshijnë:
 - i. Kuptimi i çështjeve ekonomike të përdorimit të ujit, si pikënisje në vlerësimin e ndikimit të rikthimit të cilësisë së ujit në sektorët ekonomik që kanë role dhe rëndësi domethënëse në ekonominë lokale dhe rajonale.
 - ii. Mbështetja e zhvillimit të instrumenteve ekonomike dhe financiare për përmbushjen e objektivave mjedisore.
 - iii. Vlerësimi i mundësive për arritjen e objektivave mjedisore me kosto më të ulët.
 - iv. Vlerësimi i ndikimit ekonomik të programeve të propozuara të masave; dhe
 - v. Vlerësimi i rajoneve/trupave ujqorë ku objektivat mjedisore duhet të bëhen më pak të rrepta për të marrë parasysh ndikimet ekonomike dhe sociale në kërkim të qëndrueshmërisë së përgjithshme.Për të arritur objektivat e listuara do të kryhen disa lloje të analizave ekonomike, si:
 - Zhvillimi i një skenari bazë socio-ekonomik për pellgun, duke përfshirë një përshkrim të rëndësisë së përdorimit të ujit dhe ekosistemit ujqor;
 - Analiza e rikuperimit të Kostos;
 - Analiza e përballueshmërisë së shërbimit të ujit;
 - Analiza e efektivitetit të kostos; dhe
 - Analiza kosto-përfitim i masave të identikuara.
 - c. Analiza shumë-kriterëshe e masave të identikuara. Përveç analizës kosto-përfitim ekonomik, priorizimi i masave plotësuese ose grupeve të masave do të realizohet bazuar në analizën shumë-kriterëshe. Do të aplikohet Procesi i Hierarkisë Analitike, i cili mbështetet në një sërë kriteresh alternative vlerësimi dhe opsionesh alternative

për përzgjedhjen e vendimeve më të preferuara. Kriteret e vlerësimit do të përfshijnë, por pa u kufizuar në, efektivitetin, kërkesat financiare, përfitimet mjedisore, përfitimet socio-ekonomike, kërkesat për burime njerëzore, etj.

- d. Përgatitja e planeve të veprimit për zbatimin e masave PM, të mbështetura nga priorizimi i bazuar në IVTU (SWAT), qasja e përdorur në Strategjinë Shtetërore të Ujërave të Kosovës dhe analiza e shumë-kriterëve. Planet e veprimit do të përgatiten për secilin pellg individualisht dhe do të shoqërohen me një plan të konsoliduar veprimi në nivel shtetëror. Plani shtetëror i veprimit do të priorizojë masat e zbatimit sipas pellgjeve, duke marrë në konsideratë skenarët real të financimit për PMPL-të.
- e. Prezantimi i draft PMPL-ve tek palët e interesit në takimet konsultative (duke përfshirë pjesëmarrjen e publikut në zhvillimin e draftit dhe planeve përfundimtare të menaxhimit të pellgut);

Rezultatet priten jo vetëm të zgjidhin mangësitë e PMPL-së ekzistuese për Drinin e Bardhë / draft PMPL-ve për Ibër, Moravën e Binçës dhe Lepencin, por gjithashtu të krijojnë inputin kritik për mundësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të ujërave në nivel shtetëror. Për më tepër, rishikimi i PMPL-ve do të koordinohet dhe do të jetë plotësisht në përputhje me dispozitat dhe kërkesat e aktiviteteve të tjera në zhvillim në Kosovë që përqendrohen në mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve ujore.

3. AKTET RELEVANTE TË BE-SË DHE KALENDARI I AKTIVITETEVE PËR HARTIMIN E PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PELLGUT LUMOR

- Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 23 tetor 2000 që vendos një kornizë për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës së ujit (Direktiva Kornizë për Ujëra) (OJ L 327, 22.12.2000), e ndryshuar më vonë nga Direktiva e Komisionit 2014/101/EU e datës 30 tetor 2014, që ndryshon dhe plotëson Direktivën 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, që vendos një kornizë për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës së ujit (Tekst me relevance për AEM) (OJ L 311, 31.10.2014).
- Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 qershor 2001 për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis (OJ L 197, 21.7.2001)
- Direktiva për qasjen publike në informacionin mjedisor (2003/4/EC) është një direktivë e Bashkimit Evropian me titullin e plotë "Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 28 janar 2003 për aksesin publik në informacionin mjedisor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 90/313/EEC.
- Direktiva 2007/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2007 mbi vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet (OJ L 288, 6 nëntor 2007).

NEVOJA PËR PËRFSHIRJE TË PALËVE TË INTERESIT

MMPHI është e vetëdijshme se pellgjet e lumenjve të Kosovës janë subjekt i ndikimeve të rëndësishme nga burime të ndryshme, si shkarkimi i drejtpërdrejtë i ujërave të zeza të patrajtuar nga amvisëritë, bizneset e ndryshme industriale, ndotja nga bujqësia, etj. Shumë nga vendbanimet në zonat rurale të pellgjeve lumore gjithashtu nuk disponojnë kapacitet për trajtimin e ujërave të zeza. Hedhja e mbeturinave në shumë trupa ujqorë është e zakonshme, dhe si rezultat, shumë lumenj kryesorë dhe përrenj të vegjël paraqesin shenja të dukshme ndotjeje. Kjo paraqet një rrezik për shëndetin dhe degradon me shpejtësi ekosistemet natyrore. Shumë zona me rrezik për përmbytje janë identifikuar në Pellgjet e Lumit të Ibër, Moravës së Binçës dhe Lepencit. Ndikimet e ndryshimeve klimatike janë tashmë të dukshme. Gjatë dhjetë viteve të fundit, kemi përjetuar përmbytje dhe thatësira ekstreme në disa nga pellgjet e lumenjve. Parashikimet sugjerojnë se burimet ujore mund të pakësohen gjithnjë e më shumë në të ardhmen. Prandaj, presioni i dëmshëm mbi burimet ujore dhe cilësinë e ujit ka të ngjarë të rritet në të ardhmen.

Të gjitha këto presione kanë ndikime negative mbi njerëzit dhe ekosistemin. Prandaj, është e domosdoshme të ndërmerren veprime dhe të përfshihen të gjitha palët përkatëse, qoftë si përdorues të ujit apo si përgjegjës për menaxhimin e burimeve ujore. Këto palë duhet të luajnë një rol aktiv në përdorimin dhe mbrojtjen e qëndrueshme të burimeve ujore.

MMPHI ka krijuar një mekanizëm për të siguruar dhe lehtësuar përfshirjen e palëve të interesit përmes një platforme të njohur si Mekanizmi Gjithëpërfshirës i Palëve të Interesit (MGPI). Qëllimi i MGPI është mobilizimi i palëve të interesit në nivele të ndryshme, përfshirë nivelin e pellgjeve, me qëllim përmirësimin e angazhimit dhe pjesëmarrjes publike.

Ky dokument ofron informacion mbi procesin e planifikimit (kalendarin e aktiviteteve), duke përfshirë afatet e çdo etape për zhvillimin e PMPL-ve. Qëllimi është të informohen të gjitha palët e interesit dhe publiku më i gjerë mbi procesin e planifikimit, hapat përkatës dhe afatet, në mënyrë që të gjithë të interesuarit të jenë në dijeni të vendit dhe kohës së ndërhyrjeve.

Pritet që palët e interesit të japin inputin e tyre mbi (por jo vetëm):

- Identifikimin e çështjeve kryesore,
- Përcaktimin e objektivave,
- Programin e masave,
- Prioriteteve,
- Financimin e programit të masave,
- Mundësitë dhe alternativat e përgjithshme të menaxhimit të ujit.

3.1 Kërkesat për përfshirjen e palëve të interesit sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës

Sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës (Nr. 04 / L-147), Neni 33 dhe Neni 84, autoriteti kompetent është i detyruar të konsultohet zyrtarisht me palët e interesit dhe të marrë parasysh mendimet e tyre. Pas datës së publikimit të këtij dokumenti, palët e interesuara do të kenë mundësinë, brenda 2 muajve, të kontribuojnë në punën e Planifikimit të Menaxhimit të Pëllgjeve Lumore për periudhën 2022-2028. (koha e Planit të Menaxhimit të Pëllgjeve Lumore, sipas Direktivës Kornizë të Ujërave 2000/60/EC dhe Parlamentit të BE-së) për të vazhduar përmirësimin e mjedisit të ujit në pëllgjet e lumenjve.

Gjatë kësaj periudhe, do të përdoren të gjitha mënyrat e mundshme për të arritur tek palët e interesit dhe për të zbatuar një proces të përshtatshëm konsultimi, duke përfshirë organizimin e takimeve individuale dhe grupe me palët e interesit, por do të përdoren edhe mjete të tjera, si mediat elektronike (përfshirë ato sociale), pyetësorë formalë, etj.

Neni 21: Përcakton krijimin e Autoritetit të Rajonit të Pëllgjeve Lumore (ARPL)

Neni 30: Përcakton dokumentet bazë për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve ujore në territorin e Republikës së Kosovës, të cilat janë:

- Strategjia Shtetërore për Ujërat, dhe
- Planet e Menaxhimit të Pëllgjeve Lumore.

Neni 32: Përcakton që ARPL përgatit një PMPL për çdo pëllg lumi në Kosovë, i cili është i vlefshëm për një periudhë prej gjashtë vitesh. Me propozimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejshëm Ministria), Plani i Menaxhimit të Pëllgjeve Lumore (PMPL) do të miratohet nga Qeveria.

Neni 33: Përcakton që për të siguruar pjesëmarrjen publike në hartimin e planit, ai duhet të publikohet dhe t'i dorëzohet publikut:

- Kalendar dhe programi i punës për hartimin e planit;
- Një deklaratë e çështjeve të rëndësishme në menaxhimin e ujërave, të paktën tre (3) para periudhës së mbuluar nga plani; dhe
- Hartimi i Planit të Menaxhimit të Pëllgjeve Lumore të paktën një (1) vit para fillimit të periudhës që mbulohet nga plani.

Neni 84: Përcakton dispozita shtesë mbi pjesëmarrjen publike në procesin e zhvillimit të PMPL-së.

Neni 84: Përcakton dispozita të detajuara për pjesëmarrjen publike në zhvillimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra dhe Planit të Menaxhimit të Pëllgjeve Lumore (PMPL). Autoritetit hartues i kërkohet të përgatisë një plan projekt për debat publik para përfundimit të dokumenteve. Publiku dhe palët përkatëse të interesit, përfshirë autoritetet qendrore dhe vendore, organizatat joqeveritare, mbajtësit e të drejtave të ujit dhe palët e tjera të interesuara, duhet të informohen për procesin e hartimit të paktën një vit përpara. Gjatë kësaj periudhe, publiku duhet të përditësohet rregullisht mbi

progresin dhe t'u jepet mundësia për të rishikuar dhe dorëzuar komente mbi planin e projektit brenda një periudhe dymujore pas publikimit të tij. Po ashtu, Strategjia e përfunduar dhe PMPL duhet të shpallen të paktën një vit para fillimit të periudhës së zbatimit. Këto dokumente do të rishikohen çdo pesë vjet, me ndryshime dhe plotësime që do të bëhen duke ndjekur të njëjtin proces si gjatë miratimit të tyre fillestar. Pjesëmarrja publike kërkohet gjithashtu në procedurat për dhënien e koncesioneve dhe lejeve për ujë, siç rregullohen nga aktet nënligjore.

3.2 Kalendari i aktiviteteve për hartimin e Planeve të Menaxhimit të Pellgut Lumor sipas aktit relevant të BE-së

Afati i PMPL/PMRP të BE-së është paraqitur në Tabelën 1 më poshtë.

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033
RBMP(s)	2nd RBMP implementation						3rd RBMP implementation						4th RBMP implementation					
FRMP(s)	1st FRMP implementation						2nd FRMP implementation						3rd FRMP implementation					
preparation				preparation of the 3rd RBMP and of the 2nd FRMP						preparation of the 4th RBMP and of the 3rd FRMP						preparation of the 5th RBMP and of the 4th FRMP		

Figura 2. Korniza kohore e PMPL dhe PMRP e BE-së në të gjitha Shtetet Anëtare të saj

Tabela 1: Korniza kohore e PMPL/PMRP-së të BE-së dhe afatet e publikimit

PMPL	PMRP
Kalendari dhe programi i punës (i publikuar të paktën 3 vjet para fillimit të periudhës së zbatimit - periudha e konsultimit 6 muaj)	Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmytjet i publikuar: dhjetor 2011, dhjetor 2018 dhe 6 vjet më pas)
Përmbledhje përkohshme e çështjeve të rëndësishme të menaxhimit të ujërave (e publikuar të paktën 2 vjet para fillimit të periudhës së zbatimit - periudha e konsultimit 6 muaj)	Hartimi i rrezikut nga përmytjet i publikuar: Dhjetor 2013, Dhjetor 2019 dhe çdo 6 vjet më pas)
Drafti version i PMPL-së (publikuar të paktën 1 vit përpara fillimit të periudhës së zbatimit-periudha e konsultimit 6 muaj)	PMRP i publikuar dhjetor 2015, dhjetor 2021 dhe çdo 6 vjet më pas
PMPL i miratuar	PMRP i miratuar

4. KORNIZA KOHORE DHE PROGRAMI I PUNËS (2025-2027) PËR PËRGATITJEN E PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PELLGUT LUMOR PËR PERIUdhËN E PLANIFIKIMIT 2028–2033

PLANI I PUNËS ME AFATIN KOHOR INDIKATIV

Qëllimi i këtij programi të punës është të sigurojë një qasje të integruar për menaxhimin e burimeve të ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor në pellgje, duke përfshirë aspektet hidromorfologjike, klimatike, ekologjike, shoqërore dhe ekonomike, sipas dispozitave të Ligjit të ujrave, dhe të sigurojë qasje në të dhëna, pjesëmarrje aktive të publikut dhe konsultime në procesin e planifikimit.

Sipas Ligjit, Plani i Menaxhimit të Pellgjeve Lumore zhvillohet në disa faza që ndjekin një metodologji të strukturuar sipas Direktivës Kornizë të Ujërave (DKU). Këto faza përfshijnë të gjitha hapat kyç nga përgatitja deri te zbatimi i planit, duke përfshirë:

Programi i punës	Afati kohor indikativ
Faza 1: Përgatitja dhe organizimi fillestar	
- Ngritja e strukturës bazë për përgatitjen e planit, organizimin e institucioneve, përcaktimin e objektivave dhe afatin kohor. Kjo përfshin: - Përcaktimi i grupeve të punës dhe trupave organizativ. - Përcaktimi i zonës së pellgut të lumit. - Identifikimi i aktorëve kryesorë. - Përgatitja e planit kohor dhe programit të punës.	Afati i fundit: Janar 2025
Faza 2: Karakterizimi i pellgut të lumit – Analizë e thelluar e pellgut lumor dhe trupave ujqorë, duke përfshirë presionet, ndikimet dhe përdorimin e ujit. Kjo përfshin:	
2.1. Përcaktimi i Trupave të Ujit – Procesi i identifikimit dhe hartimit të kufijve të trupave të ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor. Ky proces përfshin përcaktimin e njësive hidrologjike natyrore dhe sistemeve hidrografike. Përfshin: - Analiza e të dhënave ekzistuese hidrografike. - Hartimi i trupave ujqorë duke përdorur teknologjinë GIS. - Krijimi i hartave të zonës së pellgjeve dhe kufijve të saj. - Tipologjia e trupave ujqorë.	Përcaktimi i trupave ujqorë Kohëzgjatja: Janar 2025 – Qershor 2025 Afati i fundit Qershor 2025
2.2. Zbatimi i Programit të Monitorimit Kjo përfshin: - Zhvillimi i një koncepti monitorimi dhe një plani monitorues që mbulon vendndodhjet, parametrat dhe metodologjitë. - Ngritja e stacioneve monitoruese (për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore). - Mbledhja e të dhënave përmes matjeve të rregullta (kimike, fizike, biologjike). - Analiza e të dhënave të mbledhura për të përcaktuar tendencat dhe ndryshimet.	Zbatimi i Monitorimit Mbikëqyrës Kohëzgjatja: Monitorimi mbikëqyrës do të zgjasë për 3 vjet (Afati: Rregullisht deri në Dhjetor 2026)
2.3. Karakterizimi i trupave ujqorë - Kjo përfshin analizën e karakteristikave hidrologjike, hidrokimike dhe biologjike të trupave ujqorë. Përfshin: - Përcaktimi i kushteve referuese për trupat ujqorë. - Përcaktimi i cilësisë së ujit (parametrat kimikë, parametrat fizikë, treguesit biologjik). - Vlerësimi i sasive të ujit (disponueshmëria e burimeve). - Identifikimi fillestar i presioneve natyrore dhe antropogjene (ndotja, ndryshimi i habitatit, etj.). - Përcaktimi i statusit të trupave ujqorë.	Karakterizimi i trupave ujqorë Kohëzgjatja: Janar 2025 – Dhjetor 2026 Afati i fundit: Dhjetor 2026
Faza 3. Identifikimi i çështjeve të rëndësishme në menaxhimin e ujit - Përcaktimi i prioritetëve në menaxhimin e ujit në pellgun lumor. Kjo përfshin:	Identifikimi i çështjeve të rëndësishme në menaxhimin e ujërave

Programi i punës	Afati kohor indikativ
	Afati i përfundimit: Dhjetor 2025
3.1. Analiza e çështjeve të rëndësishme si ndotja, përdorimi i ujit, menaxhimi i ujërave të zeza, mbrojtja e ekosistemeve.	
Për ndotjen e ujit: - Identifikimi i ndotësve kryesor dhe burimeve të tyre (industriale, bujqësore, urban). - Vlerësimi i ndikimit të ndotjes në cilësinë e ujit dhe ekosistemet. - Zhvillimi i masave për reduktimin e ndotjes. Përdorimi i ujit: - Analiza e përdorimit aktual të ujit në sektorë të ndryshëm (bujqësi, industri, amvisëri). - Identifikimi i zonave me përdorim të tepëruar të ujit dhe zhvillimi i strategjive për menaxhim racional. - Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike në burimet ujore dhe përdorimin e ujit. Menaxhimi i ujërave të zeza: - Vlerësimi i sistemeve ekzistuese të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. - Identifikimi i mangësive në menaxhimin e ujërave të zeza dhe sugjerimet për përmirësim. - Zhvillimi i strategjive për rritjen e efikasitetit të menaxhimit të ujërave të zeza dhe reduktimin e rreziqeve për trupat ujorë. Mbrojtja e ekosistemeve: - Identifikimi i ekosistemeve kryesore në pellgun e lumit dhe rëndësia e tyre. - Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve njerëzore në ekosistemet dhe zhvillimi i masave mbrojtëse. - Mbështetja e nismave për rivendosjen e ekosistemeve të degraduara dhe integrimin e tyre në menaxhimin e ujit.	Analiza e çështjeve të rëndësishme Afati i fundit për publikim dhe konsultim: Qershor 2025
3.2. Përfshirja e palëve të interesit përmes konsultimeve për të konfirmuar prioritetet	
Konsultime me palët e interesit: - Organizimi i punëtorive, seminareve dhe grupeve të fokusit për shkëmbimin e informacionit dhe pikëpamjeve. - Përfshirja e komuniteteve lokale, organizatave joqeveritare, sektorit privat dhe institucioneve qeveritare në procesin e konsultimit. - Mbledhja e feedback-ut nga palët e interesuara për të konfirmuar prioritetet e identifikuara. Hartimi i dokumentacionit: - Përgatitja e një raporti për çështje të rëndësishme në menaxhimin e ujërave, duke përfshirë prioritetet e identifikuara dhe masat e propozuara. - Lëshimi i raportit për publikun dhe palët e interesuara për komente dhe sugjerime të mëtejshme. - Publikimi i raportit tek publiku dhe palët e interesuara për komente dhe sugjerime të mëtejshme 60 ditë.	Përfshirja e palëve të interesit Publikimi i raportit: Data e publikimit qershor 2025 Periudha e komenteve: Mbledhja e komenteve: Shqyrtimi i komenteve të marra dhe përgatitja e raportit përfundimtar: Nëntor 2025
Faza 4: Analiza e Presioneve, Rreziqeve dhe Ndikimeve	

Programi i punës	Afati kohor indikativ
4.1 Analiza e Presioneve dhe Ndikimeve - Identifikimi i burimeve kryesore të presionit (industria, bujqësia, zhvillimi urban). - Vlerësimi i ndikimit të këtyre presioneve në cilësinë dhe sasinë e ujit. - Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike.	Analiza e Presioneve dhe Ndikimeve Kohëzgjatja: Janar 2025 – Dhjetor 2026
4.2 Vlerësimi i rreziqeve nga ndotja: - Mbledhja e të dhënave për ndotësit (kimikatat, toksinat) dhe burimet e tyre. - Vlerësimi i ndikimit të ndotësve në trupat dhe ekosistemet ujore. - Modelimi i rreziqeve të ndotjes, duke përfshirë skenarët për kushte të ndryshme (p.sh., përmbytjet, reshjet).	Vlerësimi i rreziqeve nga ndotja Kohëzgjatja: Janar 2025 – Dhjetor 2026
4.3 Vlerësimi i ndryshimeve hidromorfologjike: - Analiza e ndryshimeve të shtretërve të lumenjve dhe ndikimi i tyre në ekosistemet ujore - Vlerësimi i ndikimit të ndërhyrjeve hidromorfologjike (p.sh., ndërtimi i digave, rregullimi i lumenjve). - Identifikimi i zonave kritike për përmirësimin e kushteve hidromorfologjike.	Vlerësimi i Ndryshimeve Hidromorfologjike Kohëzgjatja: Janar 2025 – Dhjetor 2026
4.4 Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmbytjet: - Vlerësimi i ndikimit të mundshëm të përmbytjeve në infrastrukturë, ekosisteme dhe popullsitë. - Zhvillimi i strategjive të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.	Vlerësimi i rrezikut nga përmbytjet Kohëzgjatja: Janar 2025 - Dhjetor 2026
4.5 Analiza e Ekosistemit dhe Faktorëve Biologjikë Përshkrimi: Identifikimi dhe analiza e shërbimeve të ekosistemit dhe faktorëve biologjik që ndikojnë në cilësinë e ujit dhe shëndetin e trupave ujorë. Përfshin: I. Analiza e ekosistemit dhe e zonës së mbrojtur: - Hartimi i ekosistemeve në zonën e pellgut lumor. - Vlerësimi i shëndetit të ekosistemit dhe aftësisë së tyre për të rregulluar cilësinë e ujit. - Identifikimi i habitateve kritike dhe specieve që varen nga burimet ujore. - Zonat e mbrojtura dhe ndikimet e mundshme. II. Analiza e Faktorëve Biologjik: - Vlerësimi i biodiversitetit të trupave ujorë dhe rrethinave të tyre. - Analiza e ndikimit të specieve invazive në ekosistemet lokale. - Studimi i treguesve biologjik për cilësinë e ujit (p.sh., llojet e peshqve dhe organizmat makrobiologjikë).	Analiza e ekosistemit dhe e faktorëve biologjikë Kohëzgjatja: Janar 2025 – Dhjetor 2026 Afati i fundit për publikim dhe konsultim: Dhjetor 2026
Faza 4. Përcaktimi i objektivave mjedisore	
Përcaktimi i objektivave specifike për ruajtjen ose përmirësimin e statusit të trupave ujorë. Ai përfshin: - Vendosja e objektivave për një status të mirë ekologjik dhe kimik të ujërave. - Përcaktimi i afateve për arritjen e objektivave. - Përcaktimi i përjashtimeve nëse disa objektiva nuk mund të arrihen brenda një periudhe të shkurtër.	Nga janari deri në qershor 2026
Faza 5. Zhvillimi i një programi masash	
Zhvillimi i një sërë masash për menaxhimin e ujit, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara mjedisore. Kjo përfshin: - Zhvillimi i masave bazë që janë të detyrueshme sipas direktivave. - Zhvillimi i masave shtesë për çështje specifike në pellgjet lumore. - Përgatitja e një vlerësimi financiar dhe kornizës kohore për zbatimin e masave.	Nga Janari deri Tetor 2026 Afati i fundit për publikim dhe konsultim: Dhjetor 2026

Programi i punës		Afati kohor indikativ
Faza 6. Përgatitja e draft-dokumentit të PMPL-së		
Konsolidimi i të gjitha analizave, objektivave dhe masave në një draft-dokument për PMPL. Kjo përfshin: - Përfshirja e të dhënave karakterizuese, objektivave mjedisore dhe programit të masave. - Përgatitja e një plani për ndjekjen e implementimit. - Zhvillimi i analizave ekonomike për shfrytëzim të qëndrueshëm të ujit		Afati i fundit për publikim dhe konsultim: Janar 2027
Faza 7. Konsultimi publik		
Përfshirja e publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të planit. Përfshin: - Publikimi i draft dokumentit për konsultim publik (të paktën 6 muaj). - Organizimi i dëgjimeve publike dhe takimeve me palët e interesit. - Procedura për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit Mjedisor - Vendosja e komenteve dhe rekomandimeve nga publiku dhe ekspertët në versionin final të planit.		Publikimi i draft dokumentit për konsultim publik - Kohëzgjatja: Të paktën 6 muaj - Data e publikimit: Janar 2027 - Afati i fundit për komente: Qershor 2027 Organizimi i dëgjimeve publike dhe takimeve me palët e interesit dhe seanca dëgjimore me ekspertë - Kohëzgjatja: seancat dëgjimore publike/dëgjimet e ekspertëve 1 shkurt 2027 15 prill 2027 15 qershor 2027 Vendosja e komenteve dhe rekomandimeve nga publiku dhe ekspertët në versionin përfundimtar të planit Periudha e përpunimit të komenteve: korrik 2027
Faza 8. Finalizimi i PMPL-së		
Finalizimi dhe miratimi zyrtar i planit. Kjo mbulon: - Përfshirja e komenteve nga konsultimet publike në versionin përfundimtar. - Finalizimi i Dokumenteve Ligjore dhe Dërgimi për Miratim. - Miratimi nga organet kombëtare përkatëse.		Afati përfundimtar për publikimin dhe konsultimin e planit dhe miratimin: 22 dhjetor 2027
Faza 9. Zbatimi i Planit dhe Ndjekja e Zbatimit.		
Monitorimi i zbatimit të masave dhe arritja e objektivave mjedisore. Kjo përfshin: - Monitorimi operativ i cilësisë dhe sasisë së ujit. - Rishikimi i PMPL-së sipas nevojës (çdo 6 vjet). - Përshtatja e masave sipas rezultateve të monitorimit. Këto faza sigurojnë vazhdimësi në planifikimin dhe menaxhimin e pellgjeve të lumenjve, duke përfshirë një rol aktiv të publikut dhe palëve të interesit në çdo hap.		2028

5. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË PROCESIN E ZHVILLIMIT TË PMPL-së

Tabela 1 Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e PMPL-së

Organizata / Institucioni	ROLI							
	Përgjegjës / Drejtuesi kryesor	Asistencë në koordinim	Koordinator/Fasilitator	Rishikimi dhe validimi i rezultateve	Ofrues i të dhënave (Data provider)	Ofrues i kontributit (Input provider)	Mbështetja kryesore teknike	Kontributi i ekspertit (Expert input)
PMPL	x	x		x	x	x		x
Grupet e Punës		x		x		x		x
AKMM				x	x	x		x
IHMK				x	x	x		x
Departamentet e Mjedisit				x		x		
Inspektorati				x		x		
Institucionet tjera përkatëse				x	x	x		
MIBU-K-PFU-AEM & konsulentët		x	x	x		x	x	x
MGPI						x		

6. KONTAKTI DHE PROCEDURA PËR MARRJEN E DOKUMENTACIONIT DHE INFORMACIONIT TË NEVOJSHËM

Tabela 2. Kontakti për marrjen e të dhënave, dokumenteve dhe informacionit

KONTAKTE PËR MARRJEN E INFORMACIONIT SHITESË DHE DOKUMENTEVE	kosovo@skat.ch
---	--